



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:260419  
Datë: 21.03.2024  
Numri i dokumentit: 05485301

Ac.nr.4333/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi, dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. K. nga fshati Shalë Komuna Lipjan të cilën e përfaqëson Nebih Troshupa avokat në Lipjan, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Olumbie Haliti, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.207/2017 datë 16.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN të pa themelta ankesat e paditësit F. K. nga fshati Shalë Komuna Lipjan dhe të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.207/2017 datë 16.02.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.207/2017 datë 16.02.2021, ka vendosur: I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. K. nga fshati Shalë Komuna Lipjan, dhe OBLIGOHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli ne Prishtinë, që në emër të të gjitha formave te kompensimit te dëmit material dhe jo material te shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 06.08.2016 në Prishtinë, paditësit F. K. t’ia paguaje shumën totale prej (...), si ne vijim:

- Për dhimbje fizike shumë prej.....5,000.00 .- €;
- për frikën e pësuar shumë prej.....4,000.00 .-€
- për shëmtim trupor shumë prej..... 2,500.00 .-€
- për shkak të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor shumë prej..... 4,500.00 .-€

Në emër të dëmit material t'ia paguajë shumat si vijon:

- Në emër të ndihmës dhe përkujdesit nga personi tjetër shumë prej..... 255.00.- €;
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej..... 195.00 .-€;

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 16.02.2021 e gjer në përmbushjen definitive të detyrimit.

II. OBLIGOHET e paditura që në emër të pagesës së shpenzimeve procedurale, paditësit t'ia paguaje shumën totale prej 3,684.20-euro në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit F. K. mbi shumën e aprovuara sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi refuzohet si e pabazuar, si dhe refuzohet në tersi kërkesa e paditësit për shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik dhe shpenzimet e mjekimit.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi F. K., brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin a ankimuar dhe ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesë padinë e paditësit, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu kundër këtij aktgjykimi, e paditura, Byroja Kosovare e Sigurimeve, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi F. K. nga fshati Shalë Komuna Lipjan, me datën 15.05.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensim dëmit material dhe jo material, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, ka bërë precizimin e kërkesë padisë, duke kërkuar konkretisht si në parashtresën e dorëzuar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.207/2017 të datës 16.02.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Nuk është kontestues fakti që me dt: 06.08.2016 në magjistralen Prishtinë-Ferizaj përkatësisht në fshatin Babush nga automjeti A Ford Fokus me targa Y-...-LRC , automjetit B-Audi A4 me traga PR-351-AAA dhe automjetit C- M.. B. me targa VD -... -.. , deri te aksidenti ka ardhur kur drejtuesi i automjetit A. H. ka drejtuar A në magjistralen Prishtinë Ferizaj dhe me te arritur në afërsi te fshatit Babush përball restorant “Burdushi” duke mos e përshtatur shpejtësinë e kushteve të rrugës për një moment ka humbur kontrollin ndaj automjetit të tij dhe nga pakujdesia ka dal në shiritin e majtë të rrugës dhe godet me pjesën e par të majtë te përparme në pjesën e par të majtë të automjetit B i cili ka ardhur nga kahja e kundërt dhe pas kësaj goditje, e ka goditur edhe automjetin C në pjesën e përparme të tij, me ç ‘rast lëndime trupore ka pësuar, i cili fakte është vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit e dt. 14.05.2019 e ekspertit të komunikacionit B.. L., i cili ka konstatuar se aksidenti i komunikacionit te dt.12.09.2016, ka ardhë si pasoj e lëshimeve të shoferit të automjetit A ( Ford Fokus) me targa Y 1...LR.. .

Më tej ka shtuar se: Gjykata, gjykata lidhur me natyrën e lëndimeve të paditësit është bazuar në ekspertizat e ekspertëve mjekësor Dr. A. T.-Ortoped-Traumatolog, Dr. Mu. K. psikiatër, kirurgu abdominal Dr. S. K., kirurg maksillofacial Dr.Nj. H., te cilët ne mendimin dhe konstatimin e përbashkët te dhëne me shkrim me dt. 05.02.2019, kanë konstatuar se paditësi në aksidentin e komunikacionit, ka pësuar lëndime të natyrës së rënd, të cilat kanë shkaktuar thyerje shumëpjesëshe të kockës së talusit të majtë, ndrydhje të regjionit të kokës, hundës dhe maksilar, plagë dërmishëse në regjionin balorozverkor dhe hundës dhe ostoathrosis subtalaris post traumatik sinister e të cilat lëndime konsiderohen si lëndime të renda trupore, e që karakterizohen si dhimbje te intensitetit posaçërisht te rend ne kohëzgjatje prej 20 deri në ofrimin e ndihmës mjekësore, dhimbje te intensitetit te rënd ne kohëzgjatje prej 5 ditësh kohë pas kohe deri në dhënien e terapisë, dhimbje te intensitetit te mesëm ne kohëzgjatje prej 28 ditësh periudhë e dhimbjeve për shkak të ndrydhjeve, edemës së indeve, inflamacionit dhe spazmës, dhimbje me intensitetit te ulët e njëjta ekziston edhe sot e kësaj dite sidomos gjatë ndryshimit të motit. Sa i preket frikës paditësi ka pasuar, frik primare ne kohëzgjatje prej disa sekondave për shkak të frikës nga vdekja dhe kërcënimi direkt për integritetin e tij trupor, frik sekondare te intensitetit te lart ne kohëzgjatje prej 7 ditësh e manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frike nga procedurat mjekësore, frik nga invaliditeti, kok dhembje, marramendje, frik sekondare e intensitetit mesatar ne kohëzgjatje prej 6 muajsh e manifestuar me reagime emocional te karakterit anksioz, frik sekondare e intensitetit te ulët e cila ka zgjatur ka zgjatur edhe për 2 vite të tjera .

Më tej ka shtuar se: Te paditësi zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është shprehur në përqindje 12.5.% e përcaktuar nga MSH, kapitulli III pika 2.4.9 dhe pika 2.4.2 nën a), për shkak të kufizimit të lëvizjes së regjionit talokrural në shkallë të lehtë artrozës subtalare subpostraumatike, lodhjes dhe dhimbjeve gjatë qëndrimit me të gjatë dhe ecjeve me të gjata. Shëmtimi trupor të paditësi ekziston në shkallë të lehtë për shkak të vrrajave në regjionin e zogut të shputës së majtë njëra 7 cm, tjetra 5 cm si dhe vrrajave në regjionin e ballit me gjatësi prej 4 cm duke pas parasysh edhe moshën e re të paditësit. Te paditësi ndihma dhe kujdesi i personit tjetër ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 6 javësh për të kryer disa aktivitete të përgjithshme jetësore i ndihmuar nga familjaret, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh, rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 2 herë nga 15 dite viti i par dhe dy herë nga 10 ditë viti i dytë.

Më tej ka shtuar se: Gjykata, nisur nga konstatimi i gjendjes faktike të përshkruar si më lartë, gjeti se paditësi duhet zhdëmtuar mbi bazën e përgjegjësisë, në baze të nenit 159, par. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin thuhet “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”, dhe meqenëse automjeti A- Ford Fokus ishte i siguarur të e paditura, atëherë mbi bazën e sigurimit nga autopërgjegjësia, gjykata aplikoi nenin 918 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në të cilin përcaktohet “Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguarur, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër”. Gjykata, lidhur me lartësinë e kompensimit të caktuar si në piken I të dispozitivit, iu referua dispozitave mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material të përcaktuara në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 2011/04-L-077 në të cilin thuhet “Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”, ndërsa në par.3 të këtij neni përcaktohet “Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Me nenin 183, par.1 përcaktohet “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, ndërsa në par.2 të këtij neni parashihet “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Më tej ka shtuar se: Gjykata, nisur nga arsyet e cekura ligjore, mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike, gjeti se paditësit i takon kompensimi i demit material dhe jo material si ne piken I dhe II të dispozitivit, duke vlerësuar se shumtat e gjykuara janë të mjaftueshme, koherente me natyrën, kohëzgjatjen, intensitetin e dëmeve materiale dhe jomateriale që paditësi ka pësuar në aksident komunikacioni për të gjitha kategoritë e dëmeve.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382 par. 2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, por nuk përmban as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese, ndërsa për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë është mbështetur në ekspertizat mjekësore.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e demit nuk është kontestuar nga e paditura, por e njëjta ka kontestuar lartësinë e kërkesës. Gjendjen faktike për demin jo material dhe material, për paditësin, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, Dr. A. T...-Ortoped-Traumatolog, Dr. M. K. psikiatër, Dr. S.K., kirurgu abdominal, Dr. Nj.. Heta kirurg maksillofacial, për të gjitha elementet e demit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë sepse nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve, frikën e përjetuar, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shkallën e shëmtimit truporë etj., dhe se kompensimi i demit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumtat e gjykuara sipas kategorive të demit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumtat e aprovuara për demin jo materiale dhe material, janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara

paditësit dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve mjeko-ligjor, Dr. A. T.-Ortoped-Traumatolog, Dr. M. K. psikiatër, Dr. S. K., kirurgu abdominal, Dr. Nj. H. kirurg maksillofacial. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e paditësit dhe të paditurës në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale pasi që gjykata e shkallë së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni nenit 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, kurse me dispozitën e nenit 159.1 të LMD-së, i cili parasheh që *“në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit”* ndërsa sipas nenit 183 par. 1 të LMD-së, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe lartësinë e dëmit, i cili parasheh që *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Andaj, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditësit si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur në lidhje me kompensimin e dëmit material, ndihmën dhe kujdesin e huaj si dhe ushqimin e përforcuar, pasi që Gjykata Apelit vlerëson se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar si dhe ndihmën e personit të tret, janë adekuate dhe i përshtaten natyrës së lëndimeve si dhe kohëzgjatjes së rehabilitimit të të dëmtuarit. Fakti që për këtë kategori të dëmit nuk është ofruar prova materiale, gjykata e Apelit vlerëson se edhe për kundër mos ofrimit të provave për këtë kategori të dëmit, dëmi është shkaktuar dhe se paditësit, është fakt i pa kontestueshëm se të njëjtit i janë nevojitur ushqim i përforcuar dhe

ndihma e personit të tretë pasi që një gjë e tillë janë konstatuar edhe në ekspertizat e cekura si më lartë.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësve në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AC.nr. 4333/2021, me datë 12.03.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bislimaj, d.v